



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al),

e-mail: [keshilli@bashkiak@bashkiashkoder.gov.al](mailto:keshilli@bashkiak@bashkiashkoder.gov.al)

V E N D I M

Nr. 35, datë 30.5.2017

**Mbi detajimin e transfertës specifike shtesë të akorduar për paga dhe sigurime shoqërore për funksionet e transferuara**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 30.5.2017, me propozim të Kryetares së Bashkisë, në mbështetje të nenit 40 pika 4, nenit 54 shkronja "dh", nenit 55 pika 3, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimi nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr.8 datë 13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017" i ndryshuar, ligjit 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", VKB nr. 8, datë 30.01.2017 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 dhe programit buxhetor afatmesëm për vitet 2018-2019", shkreses nr. 17951 date 28.12.2016 "Dergohet transferata specifike per vitin 2017 per funksionet specifike" dhe shkreses nr. 5862 date 27.4.2017 "Dergohet fondi i rritjes se pagave per funksionet e transferuara" nga Minsitria e Financave, VKM nr. 175 date 8.3.2017 "Per trajtimin me page dhe shtesa mbi page te punonjësve mësimore në arsimin parauniversitar", VKM nr. 187 date 8.3.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit"; VKM nr. 202 date 15.3.2017 "Për disa shtesa në vendimin nr. 717 datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjesve mbeshtetes të institucioneve buxhetore dhe të nepunesve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar, VKM nr. 350 date 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi paga të punonjesve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit", relacionin nr. 1654/b, datë 19.5.2017,

V E N D O S I:

1. Të miratohen detajimet e transfertes specifike si me poshte :

Programi 9120 – Arsimi parashkollor dhe 9- vjecar

në lekë

<b>Numri Punonjësve</b>	<b>Paga</b>	<b>Sigurime shoqerore</b>	<b>Totali</b>
Drejtoria Kopshte Cerdhe (163 veta)	3 500 000	850 000	4 350 000
Drejt.Ekon.Arsimit (76 veta )	4 111 070	2 200 000	6 311 070
<b>Totali (239 veta)</b>	<b>7 611 070</b>	<b>3 050 000</b>	<b>10 661 070</b>

Programi 9230 – Arsimi parauniversitar i mesem i perqithshem

në lekë

<b>Institucioni</b>	<b>Paga</b>	<b>Sigurime shoqerore</b>	<b>Totali</b>
Drejt Ekonomike e Arsimit (84 veta )	1 509 774	1 200 000	2 709 774

Programi 4240- Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes

në lekë

<b>Institucioni</b>	<b>Paga</b>	<b>Sigurime shoqerore</b>	<b>Totali</b>
DSHBP-Bordi i kullimit (14 veta)	756 000	126 252	882 252

Programi 4260- Administrimi i Pyjeve

në lekë

<b>Institucioni</b>	<b>Paga</b>	<b>Sigurime shoqerore</b>	<b>Totali</b>
DSHBP- Administrimi i Pyjeve ( 6 veta )	486 000	81 162	567 162

Programi 10910 - Emergjencat Civile dhe MZSH

në lekë

Institucioni	Paga	Sigurime shoqerore	Totali
Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Mbrojtjes nga zjarri (35 veta)	1 792 400	400 000	2 192 400

2. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:
  - a) rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
  - b) rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
  - c) rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.
3. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Kryetarja e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.5.2017

Shpallur në datën 31.5.2017

**Sekretar i këshillit**



Suel Hadri

**KRYETAR**



Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QARKU SHKODËR  
PREFEKT

Pr. 8970 dt. 12.06.2017

Nr.639/1 Prot

Shkodër, më 8.06.2017

**Lënda: Lidhur me vendimin e këshillit bashkiak Shkodër nr.35 datë 30.05.2017.**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin", ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 54, germa dh, neni 55/3, 64/c, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH", i ndryshuar, ligjit nr.130/2016 "Per buxhetin e vitit 2017", Udhëzimit nr.2 datë 6.02.2012 "Për procedurat standarte te zbatimit te buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit te Ministrit te Financave Nr.8 dt.13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2017", shqyrtoi VKB Shkodër nr.35 datë 30.05.2017 "Mbi detajimin e transfertës specifike shtesë të akorduar për paga dhe sigurime për funksionet e transferuara sipas shkresës nr.5862 prot dt 27.04.2017 "Dërgohet fondi i rritjes së pagave për funksionet e transferuara nga MF te programi 9120, 9230, 4240, 4260 & 10910".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mmëtejshme.

Ju rikujtohen korrigjimet që ju duhet të bëni për VKB nr.8 datë 30.01.2017<sup>1</sup>.

Me respekt,

**PREFEKTI**



<sup>1</sup> Sipas shkresës së Prefektit nr.150/1 dt 08.02.2017